



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 03, Datë 15.01.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË OST SH.A., PËR SHTYRJEN E AFATIT TË MARRJES
NË SHQYRTIM TË KËRKESËS PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË
ERE-s, NR. 169, DATË 03.11.2020, “PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR DHJETËVJEÇAR 2015-2025 TË
ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërmat “a” dhe “e”, nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3 dhe neneve 91 dhe 92 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.135, datë 06.09.2017, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 15.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 7/2 Prot, datë 13.01.2021, të Drejtorive Teknike, mbi kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) , për zgjatjen e afatit për rishikimin e Vendimit të bordit të ERE-s, nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a”

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me Vendimin nr. 216, datë 15.12.2020, vendosi shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga shoqëria OST sh.a për rishikimin e Vendimit të bordit të ERE nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.
- OST sh.a me shkresën drejtuar në ERE nr. 165 Prot., datë 11.01.2020, parashtroi se:

- Përmes shkresës me nr. 6967/2 Prot., datë 21.12.2020, është vënë në dispozicion informacioni shtesë i kërkuar për rishikimin e Vendimit nr.169, datë 03.11.2020, përkatësisht DRAFT “Metodologjia e Vlerësimit kosto-përfitim të projekteve të rrjetit shqiptar të transmetimit”, ku theksohet që ky material është hartuar nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim dhe mbetet i tillë, në pritje të finalizimit pasi të jenë reflektuar dhe elementë të tjerë që mund të dalin nga studimi i Masterplanit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.
 - Procesi i hartimit të Master Planit të OST sh.a, “Plani mbi Investimet dhe Zhvillimin e Rrjetit për Sektorin e Transmetimit të Energjisë në Shqipëri për vitet 2018 – 2033” ka hyrë në fazën përfundimtare dhe sipas skedulit të fundit të miratuar pritet që Drafti final i Master Planit të disponohet në fund të dhjetorit.
 - Gjatë vitit 2020, afati i përfundimit të Master Planit është shtyrë dy herë për shkak të kufizimeve të krijuara për shkak të pandemisë COVID-19.
 - Në respekt të përcaktimeve ligjore, Master Plani do të hyjë në fuqi pasi ai të miratohet edhe nga ERE. Për këtë arsye, nëse gjithçka shkon sipas parashikimeve të afateve, OST do të dërgojë për miratim në ERE draftin final të Master Planit për miratim brenda muajit janar.
 - Një nga risitë e Master Planit është edhe Metodologjia e zhvillimit të tij, e cila është zbatuar në studim. Ky trajtim merr në konsideratë të gjithë paketën e investimeve ekzistuese, si dhe zgjerimin, të cilit i përkasin projektet e reja që dalin si rezultat i analizës së rrjetit në projeksion për të ardhmen.
 - Duke qenë se momentalisht jemi në një fazë shumë të ngjeshur, në të cilin kërkohet një integrim dhe përqëndrim i burimeve, përshtatje e metodologjive dhe respektim të afateve të paracaktuara, për të gjitha zhvillimet aktuale dhe në të ardhmen të rrjetit të transmetimit, parashtrohet kërkesa për shtyrje.
- Për të analizuar të gjithë elementët e nevojshëm, në mënyrë që të jepet një gjykim dhe argumentim i drejtë, i saktë dhe shterues i kërkesës së parashtruar nga OST sh.a., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 169, datë 03.11.2020, OST sh.a duhet të paraqesë të gjithë informacionin e kërkuar nga ERE nëpërmjet komunikimeve zyrtare, me qëllim ezaurimin e procedurës administrative dhe marrjen e një vendimi mbi këtë çështje si dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 53, pika 3 dhe nenet 91 dhe 92 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës për rishikimin e Vendimit të bordit të ERE, nr. 169, datë 03.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.